



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.3.2022, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit.
2. Projektligji “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” (*Komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Fadil Nasufi, Luljeta Bozo, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Lefter Gështenja, Zef Hila, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka dhe Nusret Avdulla.

Mungojnë:

Laert Duraj, Tatiana Piro, Rrahman Rraja, Alqi Bllako, Flamur Hoxha dhe Fatjon Veizaj.

Të ftuar:

Elira Demiraj - Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arjana Dymishi – Drejtore e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Eralda Shtylla – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit. Kuorumi është i pranishëm. Nëse ka ndonjë nga mediat mund të hyj.

Sot në rendin e ditës, të cilin e keni përpara, kemi miratimin e procesverbaleve të komisionit të datave 31.1.2022 dhe 1.2.2022. Procesverbalet ju kanë ardhur në postën elektronike.

Kush është dakord me procesverbalet?

Në rregull.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, projektligji “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe relator është zoti Anduel Tahiraj. Për ta mbrojtur dhe për ta prezantuar këtë projektligj janë të pranishëm nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë zonja Elira Demiraj, drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, zonja Arjana Dyrmishi, drejtore e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe zonja Eralda Shtylla, përgjegjëse Sektori.

Zëvendësministri na ka informuar dje me një *e-mail* që sot për një arsye shërbimi nuk do të jetë i pranishëm në Shqipëri.

Kush do ta prezantojë projektligjin për ju?

Elira Demiraj – Projektligjin do ta prezantoj Arjana.

Arben Pëllumbi - Zonja Arjana, fjala për ju.

Më pas do të vazhdojmë me relatorin.

Elira Demiraj – Në fillim do të them unë dy fjalë për projektligjin dhe më pas do t’ia kaloj fjalën zonjës Arjana, si drejtuese e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik.

Projektligji ka ardhur si nevojë dhe natyrshëm për shkak se ligji tjetër me nr. 8957, i vitit 2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, është i vjetër. Ka pasur një sërë kërkesash nga Bashkimi Europian në bazë të direktivave dhe të mënyrës se si ata i kategorizojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe për të formatuar ndryshe edhe nevojën e kategorizimit në lidhje me mbështetjen e ndihmës shtetërore për mënyrën e organizimit dhe se si duhet të funksionojë kjo e lidhur edhe me institucionin që e zbaton AIDA-n.

Mendojmë se ishte koha e duhur për t'u sjellë, janë një sërë rekomandimesh që janë marrë parasysh dhe jemi besimplotë që ligji i përmbush të gjitha kriteret dhe nevojat e tregut sot, për më tepër për mënyrën e hartimit.

Sa i takon hartimit të projektligjit dhe sqarimeve nen për nen fjalën do t'ia kaloj zonjës Arjana si drejtuese, e cila ka marrë pjesë gjatë gjithë procesit të hartimit.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Arjana Dyrmishi.

Arjana Dyrmishi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ligji i ri për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme propozohet për t'i dhënë një kuadër ligjor që është koherent dhe u përgjigjet nevojave për zhvillimin e SME-ve në Shqipëri. Sikurse e dimë, ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme përbëjnë rreth 99,8% të të gjitha bizneseve që operojnë në Shqipërinë, pra përbëjnë edhe shtyllën kurrizore të tij. Ligji që ne kemi në fuqi është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

99,8%.

Kryesisht kuptohet që fokusi është në sektorin e tregtisë për vetë strukturën ekonomike që ka aktualisht ekonomia shqiptare. Ligji që kemi aktualisht në fuqi për biznesin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, sikurse e tha edhe zonja Demiraj, është një ligj i hartuar para 20 vjetësh. Në vitin 2013 është bërë një amendim i tij për ta mbajtur përkufizimin, sipas përcaktimeve të Bashkimit Europian.

Risia kryesore për të cilën ne erdhëm në një draft ligj të ri ka të bëjë jo vetëm për të mbajtur përcaktimet e definimit të ndërmarrjeve të vogla, sipas BE-së, por edhe për të përcaktuar në mënyrë të qartë ligjore dhe transparente se cilat janë format e mbështetjes për SME-të që ofrojnë institucionet shtetërore.

Konkretisht janë dy elemente të ndihmës shtetërore të mbështetjes për SME-të.

I pari, është elementi i mbështetjes financiare, e cila do të realizohet me anë të tre elementëve:

- krijimi i një fondi për zhvillimin e SME-ve, i cili do të menaxhohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ose siç njihet ndryshe AIDA;

- fondet që japin donatorët e huaj, ku ende ata janë prezentë me projekte të ndryshme si nga ana financiare, edhe me mbështetje këshillimore për SME-të;

- si dhe elementi i tretë i mbështetjes me garanci sovrane nëpërmjet ligjit që kemi në fuqi për borxhin dhe sipas hapësirave fiskale që ka buxheti i shtetit.

Përpos kësaj, element tjetër i mbështetjes së SME-ve në këtë ligj janë shërbimet mbështetëse. “Shërbime mbështetëse” është një term, të cilin ne e përdorim nga praktikatat ndërkombëtare dhe europiane të mbështetjes së SME-ve, të cilat kanë të bëjnë me ofrimin e këshillimit, mentorimit dhe të trajtimit të SME-ve në mënyrë të vazhdueshme. Kjo për vetë faktin, sepse sikurse e dini, në Shqipëri, por edhe në vendet si ne operojnë donatorë të ndryshëm, të cilët operojnë me projekte dhe programe të ndryshme, të cilat janë në afate kohore të caktuara me ofrimin e këshillimeve, standardeve dhe trajnimeve për SME-të. Përjasja për ne është për të kaluar në një përjasje sistematike, pra e gjithë kjo *know how* që lënë nëpërmjet projekteve të ndryshme donatorët të transformohet tek AIDA, e cila në një periudhë të mëvonshme do të jetë në gjendje që të bëjë vetë ofrimin e shërbimeve mbështetëse për SME-të.

Ky është një element i ligjit të ri, ndërkohë që dy elemente të tjera të rëndësishëm që doja t’i evidentoja kanë të bëjnë me faktin e hartimit të një raporti vjetor nga AIDA mbi gjithë ndihmën që japin për SME-të institucionet shtetërore, jo vetëm institucionet shtetërore në nivel qendror, por edhe në nivel vendor. Sikurse e dini, në bazë të ligjit për qeverisjen vendore edhe vetë pushteti vendor, bashki të ndryshme japin grante për biznesin e vogël dhe të mesëm. Ndërkohë, kemi edhe institucione dhe ministri të tjera, të cilat në bazë të politikave të tyre sektoriale dhe të bashkëpunimeve me partnerët në zhvillim ofrojnë trajnime, programe ose mbështetje financiare për SME-të.

Pra, jo vetëm AIDA, por edhe institucionet e tjera që ofrojnë të tilla programe synohet të dërgojnë informacion tek AIDA në mënyrë që në mars të çdo viti ne të kemi një raport mbi ndihmën që u është ofruar SME-ve. Pra, *who is doing watch*, kush është duke ofruar çfarë për të zhvilluar SME-të dhe kjo është edhe për të ndërtuar një platformë të mirë programesh dhe trajnimesh për SME-të në nevojë në zonat dhe në sektorët e pambuluar.

Gjithashtu, në ligj, për shkak edhe të vetë rëndësisë që kanë SME-të dhe për vetë shifrën që ju evidentova, në fillim kemi propozuar krijimin e një këshilli konsultativ për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, i cili do të përbëhet nga 18 anëtarë dhe do të ketë përfaqësi jo vetëm të limituar të institucioneve shtetërore, por edhe nga institucione të pavarura si Banka e Shqipërisë,

INSTAT-i, por, gjithashtu, kemi edhe zërin e biznesit nëpërmjet përfaqësimit dhe emrave që ata do të japin në këtë këshill, i cili do të shërbejë si një platformë për të diskutuar politikën në mbrojtje të biznesit të vogël dhe të mesëm, qoftë edhe për të monitoruar strategjitë dhe programet që janë duke zhvilluar institucionet shtetërore.

Sa i përket pjesës së përkufizimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, më lejoni ta ritheksoj që ne kemi mbajtur propozimin që është në legjislacionin ekzistues. Pra, ndërmarrje mikro janë ndërmarrjet, të cilat punojnë deri në 9 punonjës dhe kanë një qarkullim deri në 10 milionë lekë; ndërmarrje të vogla janë ato që kanë një numër punonjësish nga 10 deri në 50 dhe kanë një qarkullim deri në 50 milionë lekë dhe ndërmarrje të mesme janë ato që kanë një numër të punësuar punonjësish nga 50 deri në 250 punonjës dhe kanë një qarkullim nga 50 milionë deri në 250 milionë lekë. Këto janë të rëndësishme, sepse janë definime që janë sipas Bashkimit Europian dhe në momentin që diskutohen politikën në mbrojtje të tyre për efekte statistikore, merret gjithmonë numri i të punësuarve.

Kjo ishte një përmbledhje e risive kryesore që sjell ky ligj në krahasim me ligjin ekzistues.

Jemi të hapur për pyetje apo sqarim të mëtejshëm për ndonjë nen specifik.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja Dyrmishi!

Fjalën e ka relatori Tahiraj.

Anduel Tahiraj – Faleminderit, kryetar!

Pa dashur të përsëris ato që tha përfaqësuesja e Ministrisë së Financave, dua t'ju them disa fjalë për projektligjin që do të kalojmë sot. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Siç e tha edhe përfaqësuesja e Ministrisë së Financave, 99,8% e ndërmarrjeve janë ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme. Kjo do të thotë që është nevojshme të kemi një formatim, duke përshtatur edhe direktivat e Bashkimit Europian.

Ligji aktual ka disa të meta, si dhe ka pasur një interes të ulët deri në këtë moment për skemat e bashkëfinancimit të AIDA-s. Nuk ekziston asnjë mbështetje financiare në formën e granteve për kërkim-zhvillimin, kemi mangësi ligjore për dhënien e fondeve nga AIDA për bizneset. Që nga viti 2012 Ministria e Drejtësisë është shprehur kundër miratimit të projektvendimit të propozuar nga Ministria e Financave, duke qenë se dispozitat e referuara në

projekt nuk autorizojnë shprehimisht Këshillin e Ministrave për të nxjerrë projektvendim me përmbajtje të tillë.

Parashikimet kryesore të projektligjit janë si më poshtë:

- ndërmarrje të vogla konsiderohen ndërmarrjet me më pak se 50 persona dhe me të ardhura jo më shumë se 50 milionë lekë;

- mikro ndërmarrje, konsiderohen ndërmarrjet me më pak se 10 persona dhe me të ardhura jo më shumë se 10 milionë lekë;

- ndërmarrje të mesme konsiderohen ndërmarrjet me 50 deri në 249 persona dhe me të ardhura nga 50 deri në 250 milionë lekë.

Një risi tjetër e këtij projektligji është krijimi i Këshillit Konsultativ, siç e thanë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, ndërmjet ndërmarrjeve të mesme, të vogla dhe mikro të vogla, i cili do të shërbejë jo vetëm si organ këshillimor dhe transparence, që ngrihet pranë institucionit përgjegjës, por do të krijojë edhe një lidhje me përfaqësues nga organizatat e biznesit dhe të institucioneve shtetërore.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Tahiraj!

Fillojmë me seancën e pyetjeve dhe të diskutimeve.

Kush e do fjalën nga kolegët?

Po, zonja Bozo.

Luljeta Bozo – Meqenëse ju e keni studiuar në tërësi, kam vetëm një pyetje. Sa përqind e këti 99,8% janë ndërmarrje mikro? Janë ndërmarrjet mikro që mbizotërojnë apo të voglat, si përqindje afërsisht?

Tani që ka ardhur kriza si pasojë e luftës që Rusia i shpalli Ukrainës, kur flitet për biznesin e vogël, kush futet te biznesi i vogël, mikrot dhe të voglat apo edhe të mesmet?

Arben Pëllumbi - Po, zonja Dyrmishi.

Arjana Dyrmishi – Faleminderit!

Në bazë të të dhënave që ne kemi për vitin 2020 rezulton, pra në bazë të definimeve për SME-të, sipas numrit të të punësuarve dhe qarkullimit, që mikro ndërmarrje janë rreth 113 786, ndërmarrje të vogla janë 250, ndërmarrje të mesme janë 70 dhe ndërmarrje të mëdha janë 7. Këto janë për të gjithë sektorët e ekonomisë.

Sa i përket definimit për biznesin e vogël në momentin që përdoret në nivel politikash, më lejoni t'ju evidentoj kontekstin në të cilin flasim. "SME" është termi që përdoret për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, i cili është edhe sipas Bashkimit Europian. Në nivel europian, kur flasim për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, shkurtimi SME, janë definime që unë iu referova lidhur me numrin e të punësuarve dhe qarkullimin. Në momentin kur flasim në politika shtetërore për zhvillimin dhe për biznesin e vogël dhe të mesëm, atëherë në rast se do të jemi në kontekstin e politikave fiskale aty do t'i referohemi subjektit të tatimit mbi fitimin apo të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Pra, biznese që kanë qarkullim deri në 14 milionë lekë janë subjekte të vogla, sepse janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe mbi 14 milionë lekë kanë normën e tatimit 15%, sepse janë subjekte të tatimit mbi fitimin. Por në një zhargon të përgjithshëm kur flitet për biznesin e vogël normalisht evidentohen këto për SME-të.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Kush nga kolegët e do fjalën?

Po, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Referuar relacionit që është bashkëshoqërues i këtij projektligji, në fund, lidhur me efektet buxhetore thuhet se në vitin 2022 janë parashikuar kosto gjithsej 51 500 000 lekë, e cila përfshin grante 50 milionë, të reja besoj, dhe për krijimin dhe funksionimin e sektorit të trajnimit 1 500 000. Nuk po vazhdoj me të tjerat, sepse më bëri përshtypje diçka tjetër tek afatet e daljes së akteve normative dhe në nenin 18, në mos u gabofsha, thuhet: "Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë vendimet e parashikuara në nenin 17 të këtij ligji, si dhe ngarkohet ministri përgjegjës për ekonominë, që brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë udhëzimet e përcaktuara". Ne kemi hyrë në vitin 2022, mos duhet rregulluar ky afat, që të bëhet efektiv ky financim, sepse bëhet nul pastaj?

Arjana Dyrmishi – Faleminderit për pyetjen!

Kur është prezantuar draftligji për miratim nga Këshilli i Ministrave, nga drejtoria teknike është hartuar diku nga mesi i vitit të kaluar, ndërkohë që është miratuar në fund të vitit të kaluar më 15 dhjetor. Pra, relacioni ka nevojë për përditësim për sa i përket anës financiare.

Që në momentin e parë thamë se janë parashikuar 50 milionë lekë nga AIDA për dhënien e granteve për SME-të në kuadër të Fondit të Zhvillimit të SME-ve. Kjo shifër do të saktësohet me AIDA-n, sa realisht është buxhetor për këtë vit për grantet e SME-ve.

Gjithashtu, pjesa e kostove financiare ka të bëjë me krijimin e një sektori të trajnimeve tek AIDA, që do të bëjë trajnimet dhe aty është thjesht vetëm kostoja e stafit, domethënë shefi i sektorit dhe specialistët. Pra, janë të parashikuara vetëm rrogat e punonjësve.

Lidhur me nxjerrjen e akteve para një viti, ne jemi të hapur që ju ta ndryshoni edhe brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për arsye se në zbatim të këtij ligji do të hartohet vendimi i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave të dhënies së granteve në bazë të shumës që është buxhetuar. Do të përcaktohet vendimi i Këshillit të Ministrave për krijimin e bordit, i cili do të japë grantet; do të dalë një udhëzim i ministrit përgjegjës për ekonominë, i cili do të jetë në përputhje me udhëzimet europiane për definimin e SME-ve.

Këto akte paralelisht janë bërë gati nga ana jonë. Janë drafte që janë punuar, sepse dihej që ishte çështje kohe, kështu që me miratimin e ligjit këto akte do të miratohen menjëherë. Kështu që, edhe në rast se do të ketë ndonjë propozim që, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e ligjit të bëhen aktet nënligjore, për ne është më se e pranueshme, sepse i keni gati draftet, presim vetëm procedurën e miratimit të këtij ligji.

Arben Pëllumbi – Dëshiron dikush tjetër ta marrë fjalën?

Zoti Mziu.

Xhelal Mziu – Në fakt, janë disa projektligje që vijnë dhe nuk ndodh një azhornim i tyre.

Së pari, kanë më shumë se një vit dhe, së dyti, nuk azhornojnë, siç ishte edhe rasti që tha kolegu.

Kur shoh këtë projektligj dhe një tjetër që kaluam, më kujtohen vitet pas 1946-ës, që organizoheshin kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore. Akoma nuk e kuptoj se cili është roli që duhet të luajë ministria në këtë drejtim! Ju dhatë një shifër që kishit nja 113 mijë mikrondërmarrje, 250 mijë ndërmarrje të vogla apo 70 mijë ndërmarrje të mesme. Sa është numri i kompanive që do të përfitojnë? Sa është vlera që do të përfitojnë? Cila është referenca në raport me vendet e BE-së apo jashtë BE-së, prej nga është hartuar ky projektligj dhe efektet që ka dhënë?

Gjëja tjetër që më bën përshtypje është këshilli i përbërë nga 18 vetë, që kryesohet nga ministri i Financave. Nuk e kuptoj pse të gjithë ata aktorë do të jenë të pranishëm në selektimin e tyre, kur mund të jetë ligji ai që përcakton se kush duhet të jetë përfituesi dhe kush duhet të skualifikohet. Duhet të ketë kritere të qarta se kush përfiton dhe kush skualifikohet, si dhe arsye të përshtatshme pse skualifikohet.

Thoni se janë 3 burime financimi nga buxheti i shtetit, që fillon në vitin 2022, por me këtë mendje nuk besoj të bëhet efektiv as nga fundi i vitit 2023 për shkak të hapësirës që i keni lënë për rregullimet e kuadrit ligjor, që do një afat jo më pak se një vit. Sa parashikohet që mund të jetë masa e donatorëve të huaj?

Ndërkohë, në lidhje me mbështetjen sovrane të kredive, çfarë merr përsipër qeveria, merr thjesht ndërmjetësimin apo interesat bankare? Cila është ndihma që u jepet këtyre ndërmarrjeve?

Faleminderit!

Elira Demiraj - Faleminderit, për pyetjet!

Është e qartë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse edhe për politikëbërjen, sidomos në fushën e nxitjes së biznesit, me qëllim zhvillimin ekonomik të vendit. Zhvillimi ekonomik, në fakt, nuk është një funksion vetëm në qeverisjen qendrore, por i përket edhe bashkisë me ligjin përkatës. Për këtë arsye një ligj i tillë rregullon veprimtarinë e të gjithë atyre që duan të mbështesin biznesin e vogël dhe të mesëm.

Siç e thamë, nga vetë struktura ekonomike që kanë sektorët ekonomikë, strukturat e ndërmarrjes që ne kemi, shumicën e kemi të përqendruar në biznesin e vogël dhe të mesëm. Jo vetëm aq, por nga pandemia pamë që peshën më të madhe të punësimit të mbajtjes së individëve në punë e kanë pasur këto biznese. Kanë qenë ata më besnikët edhe ndaj stafit, kundrejt bizneseve të mëdha, që e kanë pasur të pamundur të mbajnë kosto të mëdha.

Në të gjitha rekomandimet e BE-së, pjesa e mbështetjes së bizneseve të vogla dhe të mesme është tema e ditës, është gjëja më e rëndësishme, është shtylla kurrizore e një ekonomie. Arsyeja e parë vjen nga rekomandimet e BE-së, rekomandimi që u përket ndryshimeve ku ne kemi bazuar këtë ligj është më 6 maj, 2003. Pra, ligji ynë ka qenë i vitit 2002, ndërkohë që rekomandimi i BE-së ka dalë në vitin 2003 dhe tashmë jemi në vitin 2022 që po e marrim parasysh këtë rekomandim.

Arsyeja tjetër ka pasur mbështetje dhe iniciativa të ndryshme qoftë nga projekte, qoftë nga bashki për mbështetjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, por një ligj i tillë bëhet ajo korniza që rregullon funksionet bazë mbi të cilin duhet të mbështeten, pra kush është lloji i ndihmës dhe si duhet të strukturohet kjo ndihmë, me qëllim që të shkojë te bizneset e vogla dhe të mesme.

Ligji është gjithmonë kornizë. Pjesa e kritereve që tha zotëria, mënyra, shuma, përzgjedhja dhe të gjitha elementet e tjera përcaktohen me VKM. Pra, ka një vendim të Këshillit të Ministrave dhe këtu është e përcaktuar që do të dalë vendimi i Këshillit të Ministrave, që

përcakton pikërisht kriteret se kush do të futet në këtë proces, kush do të jetë përfitues, cilat do të jenë kriteret që do të plotësojë sa do të jetë shuma që do të marrë e të tjera. Shuma që do të marrë varet gjithmonë nga mënyra se si e buxheton qeveria. Ka raste kur do të mbështeten tërësisht nga buxheti i shtetit, ka raste kur mund të jenë të koordinuara me ndihma të tjera nga financime të tjera, që mund të jenë prezent për të mbështetur këtë lloj ndihme për bizneset e vogla dhe të mesme.

Risia tjetër është që ne më parë kemi pasur vetëm konceptin e mbështetjes me grante. Pjesa e garancisë sovrane, që ju me të drejtë e prekni, është ky ligj që jep për herë të parë të drejtën që edhe bizneset e vogla dhe ato të mesme të kenë mundësinë të përfitojnë nga garancia sovrane, gjë që më parë nuk e kanë pasur. Kështu që kjo është një risi. Mënyra se si e aplikon qeveria kur vendos të financojë me garanci sovrane, përgatit paketa të posaçme, kategori të posaçme, shumën e përfitimit dhe të gjitha kriteret. Pra, këto zgjidhen me VKM. Ligji u hap rrugën të gjitha këtyre proceseve pa qenë të shënuara në ligj që bizneset e vogla dhe të mesme janë përfituese të këtyre shërbimeve.

Është e pamundur të kalosh në fazën tjetër dhe të bësh një VKM. Zotëria e tha që edhe nga Ministria e Drejtësisë një pjesë e mospranimit nga kjo ministri që nga viti 2019 ka qenë pikërisht mospërmendja në ligj e elementeve përfitues të bizneseve të vogla dhe të mesme.

Pjesa e këshillit, ne mendojmë që këshilli është një element transparence dhe kemi futur edhe institucione, të cilat janë pjesë edhe e politikëbërjes së biznesit të vogël dhe të mesëm dhe për këtë arsye është edhe Këshilli Konsultativ për ndërmarrjet. Këtë ne e kemi menduar si një element transparence duke mos e lënë fondin në dorën e vetëm një agjencie, por të një këshilli, i cili siguron që të ketë edhe një politikëbërje më të mirë, edhe vendosje kriteresh, edhe shtrirje dhe të gjitha elementet dhe mendoj që është një nga format që aplikohet më së shumti tani me borde dhe nuk aplikohet vetëm me një institucion kur bëhet fjalë për fonde të tilla. Fondi social ka shembuj nga më të ndryshmit që në ligje të ndryshme është aplikuar modeli i këshillave konsultativ.

Për pjesën e donatorëve të huaj, një nga elementet që ne kemi parë gjatë viteve të fundit ka qenë se çdo donator ka bërë një projekt me idenë dhe konceptin e vet se si duhen ndihmuar bizneset e vogla dhe të mesme, por e thotë pikërisht ky ligj që ka disa forma, ka grante, ka suport mbështetës, ato shërbime mbështetëse që janë: këshillimet, trajnimet dhe të gjitha elementet e tjera. Ky ligj vendos kuadër rregullator edhe për këto projekte dhe na jep mundësinë që ta

evidentojmë, domethënë kudo që kjo gjë të ndodhë, të ndodhë sipas një kornize ligjore, ata nuk do ta bëjnë vetëm duke parë thjesht një model sesi implementohet në një vend të zhvilluar të BE-së dhe ta sjellin këtu *coppy-paste*, por duke iu referuar një legjislacioni vendas. Për këtë arsye ne e gjykojmë se është shumë i rëndësishëm. Përveç kësaj, ne mund të sinkronizojmë fondet ose financimet që ato kanë me politikat tona, ne mund të kemi një politikë që mund ta financojnë ata, mund të jetë një gjë e përbashkët dhe për këtë arsye themi se ligji na ndihmon për të ecur drejt kësaj forme, domethënë rregullon atë që ju përmendët, burimet e financimit, që mund të jetë buxhet shtetëror, mund të jetë buxhet nga projekte të ndryshme nga qeveria gjermane, zvicerane apo kushdo qoftë në treg.

Mendoj se kjo është pak a shumë përmbledhja e atyre që ju kishit merak, por nëse ka ndonjë gjë tjetër që mund të shtojmë, mund t'ju sjellim edhe me shkrim, në qoftë se ka elemente që mund të jepen.

Mendojmë që është një ligj që i ka ardhur momenti për t'u vënë në zbatim dhe për të rregulluar shumë elemente që kanë për mbështetjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Zoti Mziu.

Xhelal Mziu – Edhe një herë ngul këmbë, sepse ju jeni ministria përgjegjëse dhe normalisht kur dalin aktet nënligjore, do të jenë analitike dhe të detajuara, por, në fund të fundit, kur hartohet një projektligj shihen edhe efektet që duhet të ketë, bie fjala, në këtë projektligj në vitin e parë parashikohet që do të ketë një interval prej iks kompanish, të cilat do të përfitojnë kaq vitin e parë, kaq vitin e dytë e me radhë në referencat dhe mbështetjet e tjera si do të jetë tendenca e tyre. Cili është impakti pozitiv që jep, sepse mbështetja nuk besoj se nuk është vetëm në aspektin financiar, por ka të bëjë edhe me konsulencën dhe ndërkohë qeveria duhet të ndërhyjë në ato pjesë, të cilat kanë të bëjnë me një revolucion teknologjik në fusha të ndryshme për ta bërë konkurrese këtë fashë biznesi, të cilën mund ta mbështesin. Pra cilat janë efektet pozitive në numra, të cilët për afërsisht përfitojnë qoftë në numër, qoftë në vlerë dhe impakti pozitiv që ato do të japin?

Arjana Dyrmishi – Lidhur me shifrat konkrete për impaktin, sikurse e tha edhe zonja Demiraj, ligji është kornizë, të cilin ia delegon Këshillit të Ministrave për përcaktimin e shumave. SME-të përfituese do të ndahen në dy kategori, janë ato që do të përfitojnë mbështetje financiare, dhe ato që do të përfitojnë format e mbështetjes si: mentorim, këshillim e të tjera.

Lidhur me numrin e subjekteve përfituese të mbështetjes financiare, më lejoni të evidentoj se kjo është ngushtësisht e lidhur me shumën në dispozicion që do të jepet në atë vit, ndaj thuhet: “Çdo vit Këshilli i Ministrave do të hartojë VKM-në për procedurën e dhënies së granteve”. Pra, është e lidhur me shumën e buxhetuar, është e lidhur me sektorin që do të evidentohet, për shembull, në mbështetje të inovacionit ose të eksporteve. Pra, ka të bëjë me sektorët e ekonomisë ku SME-të përfitojnë dhe në bazë të elementeve del dhe shuma e granteve, e cila mund të jetë, 5- 7-10 mijë euro, që është e lidhur me dy kriteret e para. Pra, ligji thjesht e ka kornizuar, sepse për shumën e buxhetuar dhe prioritet do të dalin VKM-të.

Hartimi këtij ligji është i mbështetur tek strategjia për zhvillimin e bizneseve dhe investimeve që u miratua në gusht të vitit të kaluar. Aty janë vendosur disa orientues të numrit të përfituesve dhe numrit të punësimit që synohet të gjenerohet nga miratimi i këtij ligji, pra, si në terma të subjekteve përfituese, ashtu edhe në terma të përfitimit që ata kanë.

Ndërkohë më lejoni të theksoj se pjesë e përfitimit të granteve, përveç skemës së dhënies së granteve, do të jetë edhe monitorimi i tyre nëse kanë marr grante dhe kanë mbyllur derën, apo kanë marrë grante dhe kanë gjeneruar punësim, sepse ai 10 mijë euroshi është për të blerë makineri, për të rritur numrin e të punësuarve. Pra, do të ketë monitorim pas dhënies së këtyre granteve. Prandaj do të them se do të jap një shifër të saktë, por sot jam e pasaktë unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi –Zoti Mziu, të mbarojë zonja, pastaj mund të merrni fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëni një koment rreth pyetjeve të zotit Mziu dhe të jeni më konkrete, ju lutem!

Elira Demiraj- Kjo është edhe formulë. Ndonjëherë ka edhe limit buxheti dhe nga limiti buxhetor dhe nga shifrat që do të vendosen do të përcaktohet edhe numri i bizneseve.

Unë e shpjegoja skemën si ndodh. Në shpjeguam që do të ketë bazë ligjore që e përcakton.

Unë e kuptova zotërinë e kam të qartë. Unë i thashë Arjanës që ta theksonte se ka një strategji për zhvillimin e biznesit mbi bazën e të cilit doli edhe nevoja e ligjit. Pra, janë të mbështetura në dokumente strategjike, nuk janë apriori, nuk janë gjëra që do të bëhen sot për sot. Kështu që e kuptova pyetjen dhe kjo është ideja.

Arben Pëllumbi – Po, zoti Bushati.

Helidon Bushati – Unë do të bëj disa pyetje për qartësim. Në princip nuk jemi kundër këtij projektligji, sepse ky është një projektligj që iu jep mundësi bizneseve të vogla start-up-ëve, por sidomos ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të përfitojnë fonde jo në vlera të larta. Unë e kam theksuar edhe në një moment tjetër me kolegët tuaj që fondet e shpërndara për ndërmarrjet e vogla, janë fonde të shpërndara që në vitin 2007. Atëherë institucioni që i jepte është quajtur Albinvest dhe sot quhet AIDA. Pra janë linja kreditimi për ndërmarrje të vogla e të mesme në vazhdimësi, nuk është një risi kjo. Ne nuk jemi kundër biznesit ose mundësive që biznesi të përfitojë nga fondet. Pa dyshim elementet që lidhen me VKM-të që do të dalin në funksion të ligjit, për sa i përket fondit në dispozicion, kriterëve, termave të referencës, këto janë diçka që duhet t'i keni ju parasysh, por edhe ne duke parë VKM-të.

Ju në diskutimin tuaj thatë se arsyeja e hartimit të këtij projektligji është konformiteti me direktivën europiane, ndërkohë që në relacion dhe dokumentacionin bashkëngjitur që ka na ardhur lihet të kuptohet se arsyeja është problematika e krijuar, pra elemente që lidhen me implementimin e VKM-ve. Ky është ligj. Ka pasur ligj edhe më parë dhe janë bërë VKM-të. Kështu që duhet të jeni të saktë në atë që thoni në relacion, sepse në relacion del sikur që është bërë deri tani përzgjedhja me VKM e kriterëve dhe tani po bëhet me ligj. Kriteret nuk futen në ligj, janë shumë të rralla kriteret për projekte të veçanta që vendosen me ligj.

Së dyti, keni futur elementin e këshillit konsultativ të biznesit. Edhe këtë e provuat në vitin 2013, funksionoi për një vit e gjysmë, dhatë çmimet “Bleta e vitit” dhe u mbyll kjo punë. Kështu që është një serial që e kemi parë tashmë. U bënë takimet e para me Kryeministrin në vitin 2014, funksionoi deri në vitin 2015, por pastaj u zhduk këshilli konsultativ i biznesit. Nuk janë risi këto.

Prandaj, unë mendoj që ose të bëhen në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit ose mos i futni kot, sepse duket sikur talleni me ne, me këtë komision, por edhe me komunitetin e biznesit në vetvete. Është diçka që e keni bërë në vitin 2013, ju funksionoi deri në vitin 2015, për efekt shout mediatik tani na e riktheni si një risi. Nuk qëndron fare kjo gjë.

Së treti, sa i përket fondit, ju në relacion dhe dokumentet bashkëngjitur projektligjit shkruani se janë dhënë fonde që janë diku të 53 milionë euro në varësi të viteve për një periudhë afatmesme. Tani këto fonde do të jepen nga buxheti i shtetit apo jo? Sepse vetë ligji pastaj del sikur është bërë për t'iu hedhur hi syve ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ju e keni parashikuar sa duhet të japë në vite dhe të ndarë në pjesën e ndihmës financiare dhe pjesën e

avokatisë apo të mbështetjes, kështu që duhet të jemi të qartë në këtë gjë. A do të jenë këto fonde në funksion të ndihmës për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme?

Pra, do të ketë një rishikim në ulje kur të vijë buxheti. Ne nuk duam që kur të vijë buxheti kjo linjë e ndihmesës për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të mos rezultojë fare në buxhet.

Këto janë pyetje dhe shqetësimet e mia.

Arben Pëllumni - Po, zonja Demiraj.

Elira Demiraj – Faleminderit!

Patjetër që në relacion mund të ketë nevojë për ndonjë reflektim më të qartë të Asaj që thotë zotëria në lidhje me linjën e drektoivës por që sigurisht ne epërmendëm edhe pak në filliom që nga viti 2002-2020 pas 20 vjetësh kshihte ardhur nevoja –për të ndryshuar ligjin me direktivën ose pa direktivë. Direktiva ka qenë që në vitin 2003 që do të thotë se ishte e pashmangshme për t'i rishikuar.\

Nevoja për të riparë këtë ligj ishte evidente, dhe i hap rrugën asaj që ne kemi vënë si pikë të veçantë në strategji dhe që është rritja e aksesit të financimit për ndërmarrjet vogla dhe të mesme. Po si? Do të finanohet nëpërmjet ligjit, proceduarve, VKM-ve, buxheteve që vihen në dispozicion.

Në lidhje me planifikimin e buxhetimit unë ju them se është bërë planifikimi për buxhetin tek AIDA. Si është çështja e buxhetit? Ne jemi të gjithë të vetëdijshëm që çfarë kemi planifikuar, kemi pasur tërmetet, pandeminë, luftën, pra i kemi të gjitha aspektet dhe nuk mund të marrim përsipër. Ne në buxhet e kemi planifikuar. Kemi bërë propozimin, është e planifikuar tashmë në buxhet.

Sa i përket këshillit konsultativ, diskutimi është që duhet ta kemi apo nuk duhet ta kemi. Funksionon apo jo mirë, kjo është një çështje tjetër dhe duhet ta mbajmë faturën në nëse nuk e vëmë në funksion. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme specifikisht është një trupë që duhet të funksionojë. Nëse funksion ose jo, ju mbase jeni më në dijeni, unë nuk di të them si ka ndodhur më parë, sepse unë jam e re në këtë drejtori, por mendoj se është element transparence, diskutimi platformë dhe duhet. Nuk duhet ta kemi? Po mbase do të na kërkohej, për shembull elementi i diskutimit me përfaqësuesit e ndryshëm të grupeve të interesit në këtë fushë. Kështu që kjo ka qenë arsyeja që është bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi - Fjala për zotin Gështenja.

Lefter Gështenja -Faleminderit!

Kjo maxhorancë prej 8 vjetësh i ka bërë lëmsh ministritë, pra nuk ekziston më Ministria e Punës më, në dijeninë time AKP –ja është nën varësinë e Ministrisë së Financave?

Në çfarë raporti është ky ligj me mbështetjen e biznesit për punësim? A ka impakt? Pra, a është normale që kompanitë përfituese që përfitojnë nga fondet e nxitjes së punësimit të përfitojnë edhe nga ky fond?

Së dyti, ashtu si edhe kolegu im jam me mendimin që kjo maxhorancë duhet të heqë dorë nga fryma e menaxhimit të fondeve publike me borde, me organe konsultative, sepse buxheti i shtetit pagan institucione, siç është AKP-ja, AIDA, apo të tjera që mjafton të ketë kritere të përcaktuara qartë dhe nuk besoj se ka nevojë pastaj për organe konsultative që janë një barrë për buxhetin e shtetit. Kjo mund të mos jetë pjesë që ju takon ju sot, por unë mendoj se duhet të heqim dorë nga krijimi i këtyre organeve. Unë mendoj se bordet ngarkojnë buxhetin dhe janë metoda komuniste. Kështu që do të kërkoja që, nëse mundet të behet ky korrigjim për këtë organin konsultativ.

Faleminderit!

Arjana Dyrmishi – Unë për fat kam qenë drejtuese deri para një muaji e AKP-së, kështu që e njoh shumë mirë atë që ju thatë, pra e shoh edhe nga ajo perspektivë. Drejtorja, që drejtoj, përfshin elementet e punësimit, zhvillimit ekonomik dhe arsimit profesional, kështu që e kam shumë të qartë merakun tuaj në lidhje me trajtimin e nxitjes së punësimit. Ka një element që i dallon. Në rastet e fondeve që janë dhënë për nxitjen e punësimit në kuadrin e atij ligji, fondi ka shkuar tek individ që punësohet. Kjo do të thotë se logjika e atij destinacioni të programeve të nxitjes së punësimit, siç i themi, ne është për të mbështetur atë individ që ka vështirësi në tregun e punës dhe kërkon një asistencë ndryshe. Për këtë jepen fondet dhe janë me subvencionim e pagave, sigurimeve shoqërore. Pra, logjika është që financohet individ, patjetër paratë kalojnë nëpërmjet biznesit se aty merret rruga dhe janë me deklarime bankare të gjitha. Ne kemi bërë një reformë. 4 vjetët e fundit ka qenë çdo gjë transparente dhe paratë kanë shkuar tek individ. Në rastin konkret ky ligj e çon parandë te biznesi për të nxitur investime ose për të zhvilluar konceptin e biznesit. Kjo duhet mbajtur parasysht në vendosjen e kritereve, unë e mbajtja shënim për ta parë që në vendosjen e kritereve duhet parë nëse këta biznese mund të përfitojnë nga dy lloje fondesh ose jo. Këtë e shënova.

Për pjesën e menaxhimit të fondeve, me sa e kam kuptuar unë, këshilli konsultativ nuk menaxhon fonde, pra AIDA, i ka funksionet e qarta se çfarë bën këshilli, i cili është për të krijuar fushëpamjen e gjerë të interesave të biznesit dhe për të ndërtuar se cilat do të jenë financimet, në këtë rast, pra, cili do të jetë sektori, sa biznese, sa do të jetë shuma. Këtë ndoshta nuk është e drejtë ta përcaktojë vetëm një institucion. Mund të jetë edhe kështu, por në ligj është përcaktuar që të jetë një këshill që përcakton prioritetet, pra, jo kriteret, sepse kriteret përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave se kush do të përfitojë. Pra, nëse do të jetë një biznes mikro me 9 të punësuar do të marrë 10 mijë euro, do të ketë plan biznesi, rezultat pozitiv në bilanc 3 vjetët e fundit. Pra, të gjitha këto do të përcaktohen me një vendim të Këshillit të Ministrave. Por se cili sektor do të financohet dhe si do të bëhet, do të ketë një këshill që siguron një fushëpamje më të gjerë, sipas mendimit tonë.

Fadil Nasufi - Po, zoti Gështenja.

Lefter Gështenja - Faleminderit për sqarimin!

Besoj se pa dashje gaboni te kjo, sepse Ligje për AIDA-n, qoftë edhe për shërbimin kombëtar të njësimit apo çdo institucion tjetër që menaxhon fondet publike përcakton qartë detyrat e institucionit, pastaj me VKM besoj se përcakton fushat prioritare se ku duhet të fokusohet institucioni respektiv.

Unë nuk besoj se këshilli, që ju ngulni këmbë, përcakton një fushëpamje më të gjerë dhe i përcakton ky politikat nesër. Unë mendoj se nuk është kështu, sepse këshilli është barrë për buxhetin e shtetit. Meqenëse ju vini nga Agjencia Kombëtare e Punësimit, nuk e di nëse keni pasur apo jo këshill konsultativ apo trepalësh, por këshilli konsultativ është barrë, ose, nëse më duhet ta them shqip dhe troç edhe për opinionin publik, përzien disa njerëz që orientojnë se ku do t'i çojnë fondet, nuk po e them më troç.

Elira Demiraj - Është e vërtetë që ne për programet e nxitjes kemi pasur një fokus të qartë, sepse ishin punëkërkues të papunë, të cilët ne i analizonim brenda nesh, por për fondin social për aftësinë e kufizuar është propozuar të ketë këshill. Pse është kërkuar?! Sepse aftësia e kufizuar ndërvepron me ministrinë e tjera, me Ministrinë e Shëndetësisë, institutin e Sigurimeve, domethënë janë disa agjenci të tjera që trajtojmë si çështje dhe kanë propozimet e tyre për të vendosur prioritetet. Në qoftë se ne do të fillonim të zbatonim tek Agjencia e Punësimit fondin social, i cili është për aftësinë e kufizuar, ata do të thoshin se cila është ndërhyrja e parë që ka prioritet, është aksesin, është këshillimi i bizneseve për të batuar ligjin dhe për të punësuar

persona me aftësi të kufizuar, është mbështetja në punë, është aftësimi i tyre apo trajnimi, domethënë është çështje prioritizimi dhe prespektive dhe të gjithë aktorët kanë zërin e vet dhe kanë njohuritë e veta dhe studimet e veta që bëjnë në atë fusha. Në këtë rast, unë dua të them që ky është konteksti i këshillit që krijon fushëpamje. Ne e dimë që kemi 98% biznese të vogla dhe te punësimi e dinim që kaq persona me aftësi të kufizuar të regjistruar, por kaq, ndërkohë që Ministria e Shëndetësisë ka skema pa fund për aftësinë e kufizuar, ka vlerësimet psikosociale dhe elementet të tjera, që ne nuk mund t'i dimë, sepse secili ka fushën e vet. Ne në këtë aspekt e kemi trajtuar, megjithatë, këtë e kisha për paralelizëm, sepse ka shumë të tilla, edhe fondi social është i tillë, pasi ai është në nivel qendror, pastaj në nivel bashkie. Prioritizimin e bëjnë në grup, nuk mund ta bëjë një kryetar bashkie dhe asnjë drejtori, sepse nevojat fillojnë merren për strehim për ndërhyrje për qendra sociale për të gjitha, të cilat duan një spektër më të gjerë diskutimi.

Fadil Nasufi - Faleminderit!

Lefter Gështenja - Unë nuk dua ta kthej në debat, por dua të më mirëkuptoni dhe unë ju mirëkuptoj te pjesa që ju relatuat, por nuk duhet të marrim rastet specifike, siç është kjo e shpërndarjes e ndihmës ekonomike dhe asaj sociale, sepse ky është një rast tjetër. Unë thashë që ka institucione, shteti funksionon me institucione dhe çdo institucion harton politikat e tij. Nëse ne mbivendosim institucionet, unë them se është forma më e gabuar. Nëse qeveria nuk ka besim tek institucionet, tek AIDA, tek Agjencia Kombëtare e Punësimit, apo te drejtoria e sigurimeve shoqërore, atëherë, është tjetër bisedë. Hajdeni të ngremë institucione paralele, apo të mbivendosim institucione për mënyrën sesi duhet të menaxhohen apo hartohen politikat. Për sa kohë qytetarët me taksat e tyre paguajnë njerëz, rrogëtarë, në ministritë përkatëse, në qeveri, në Ministrinë e Financave, në Ministra të Shëndetësisë, unë them të mos kemi mbivendosje, sepse nuk është normale dhe kjo është arsyeja që unë them se nuk duhet të jetë në ligj këshilli konsultativ. Edhe pse ju mund të thoni që ata nuk marrin rrogë, ata marrin një pagesë çdo muaj. Kjo ndoshta nuk duhet bërë pjesë e diskutimit, sepse ndoshta e zgjata më shumë sesa duhet.

Arjana Dyrmishi - Dua të sqaroj diçka. sikurse e thamë, një element i rëndësishëm i këtij ligji është se rregullon nga ana ligjore dhënien e mbështetjes financiare për SME-të. AIDA, në bazë të ligjit të vet të funksionimit, nga ana juridike nuk e ka të rregulluar dhënien e granteve nëpërmjet formave, përcaktimin e kritereve dhe të tjera. Ne kemi pasur diskutime me Ministrinë e Drejtësisë për këtë, sepse mungonte delegimi me anë të ligjit për Këshillin e Ministrave për të nxjerrë të tilla VKM. Prandaj edhe e kemi përcaktuar në relacion. Ligji i SME-ve, edhe kur i ka

dhjenë AIDA grantet, të cilat u referuan këtu, ka pasur për bazë ligjin e SME-ve dhe jo ligjin e vet. Fakti që nuk ishte i rregulluar ligjërisht, sepse ishte një ligj prej 20 vjetësh, ne kemi bërë rregullim ligjor të dhënies së granteve nga AIDA.

Neni kryesor, në të cilin janë dhënë grantet, neni 11, e ka të saktësuar që ky fond administrohet nga AIDA. Bordi do të krijohet sipas procedurës së transparencës së dhënies së fondeve. Janë përcaktuar kriteret e përgjithshme për t'u orientuar në dhënien e granteve dhe është përcaktuar krijimi i një portali, në vijim edhe të një përgjigjeje që u dha më parë, që çdo SME të marrë informacion. Në raportet ndërkombëtare gjithmonë jemi qortuar për arsye sepse nuk kemi procedurat e mekanizmit, ose nuk e përdorim mekanizmin e konsultimit të akteve që ndikojnë në biznesin me biznesin, krijimi i këshillit konsultativ është vetëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ku do të diskutohen politikat dhe strategjitë që kemi për zhvillimin e SME-ve në dallim me këshillin e investimeve është tjetër gjë dhe në VKM-të që do të hartohen për dhënien e këtyre granteve do të konsultohen me këtë këshill, pra do të merret edhe ideja e biznesit. Pra, ne që jemi në zyrë me AIDA-n, me ministrinë që bëjmë VKM-të, këto do të diskutohen në këtë këshill konsultativ.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'i diskutojmë me ta. Madje edhe termi i duhur që ne kemi përdorur është: “Jep mendim, këshillon lidhur me mënyrën e hartimit të skemave mbështetëse për biznesin”. Ne e kemi të referuar në raportet ndërkombëtare që duhet të kemi mekanizma transparence dhe diskutim me biznesin për akte që afektojnë ata. Kjo do të jetë një platformë, ku ndërmerr mendime. Politikën e bën Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk diskutohet kjo gjë.

Fadil Nasufi - Dakord, zonja Dyrmishi. Shqetësimi i kolegëve, të cilët morën fjalën, ishte edhe për të sqaruar teknikisht pyetjet që bënë, por edhe kontestim për mënyrën sesi funksionojnë këto borde dhe të mos kenë paralelizëm me strukturat shtetërore dhe institucionet shtetërore që menaxhojnë fondet. Kjo nuk është vetëm për këtë projektligj që kemi sot, por në përgjithësi ato që menaxhohen me borde ose me këshilla konsultativ. Kjo duhet të jetë një detyrë për ekzekutivin që t'i ketë parasysh, sepse sa herë që ka palë, qoftë në pjesëmarrjen në buxhet, qoftë për të pasur partneritete, do të ketë edhe struktura mbikëqyrëse mbi këto.

Fjala për zotin Likaj.

Ramadan Likaj - Faleminderit!

Unë mora shkas nga parafolësi gështenja dhe po i referohem asaj që të mos zgajtem më shumë.

Pak më parë ju thatë që bizneset do të klasifikohen mbi bazën e bilanceve, nëse nuk gabohem. Ministria e Financave tha se do të bëhet një përzgjedhje për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo? Dakord.

Pak më parë ju thatë që nxitja e punësimit, ku ka përfituar drejtpërdrejt individi, unë mendoj se kjo të shikohet përsëri si një mbivendosje te kjo pjesë e ligjit. Pra, me një mbikëqyrje tjetër mendoni që prapë të klasifikoni biznese dhe të nxitni disa biznese të klasifikuara nga institucione, që, realisht, janë të komanduara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht që për mua është mbivendosje e ligjit, sepse në qoftë se ligji e përcakton qartë, dhe unë jam dakord, çdo institucion që futet mbikëqyrës te një ligj, besoj se është këshillues.

Së dyti, ju thoni se nxitja e punësimit deri sot ka pasur sukses, por unë mendoj se nuk ka pasur sukses. I vetmi sukses që ka pasur gjatë këtyre viteve ka qenë gjatë fushatave. Unë nuk mendoj se biznese të mirëfillta kanë përfituar nga kjo që ju thoni, por kanë përfituar individë të diktuar për interesa personale dhe sa kanë mbaruar fushatat lekët kanë shkuar në dorë të individëve dhe jo tek ata që kanë pasur biznese të mirëfillta. Për këtë ju jap fakte.

Ju thoni 0-9 punonjës, po ashtu thoni 10-40 dhe 50-240 punonjës. Pyetja ime është e thjeshtë: çfarë përfitimi do të kenë që i nxitni ju që ai të bëhet me punonjës, sepse nëse nuk ka asnjë punonjës dhe është i regjistruar si duhet të nxitet ai? Këtu duhet të ketë rregullim shifrash.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të jetë nën zero, të lutem!

Këtu është 0-9 punonjës, por këtu nuk ka punonjës fare. Unë mendoj se diçka në këtë ligj nesër fshihet dhe dikush do të përfitojë në mënyrë selektive. Prandaj them se këto gjëra duhet të jenë pak më të qarta. Sigurisht edhe bizneset duhet ‘i kuptojnë më qartë këto gjëra. Projektligji që vjen këtu është në interes të biznesit dhe, sigurisht që do të japim mbështetjen tonë, por paqartësitë tona mbeten gjithmonë teknike, sepse një pikë e vogël prish komplet sistemin dhe nuk dihet se kush përfiton në finale.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi - Ju lutem, do të doja që në përgjigjet tuaja të qëndroni jashtë pjesës politike, deputetët janë të lirë të bëjnë të gjitha komentet që gjykojnë që janë të arsyeshme, por ju qëndroni jashtë pjesës politike dhe flisni teknikisht.

Elira Demiraj - Faleminderit!

Patjetër që ne do të përgjigjemi për atë fushë që mbulojmë te pjesa teknike. Edhe ligjin e nxitjes së punësimit unë e mora si paralelizëm me zotërinë parafolës, por nuk jam këtu që të flas për këtë, sepse është një proces krejt tjetër.

Dua të theksoj që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është e nevojshme.

Arben Pëllumbi- Koleg, ideja ishte që në kushtet që zonjat janë drejtoresha, por janë pjesë e administratës, nuk janë përfaqësimit politik, prandaj nuk duhet të hyjnë në debate politike, po të kishim zëvendësministrin, sigurisht që do të hynte në debate politike.

Elira Demiraj - Në këtë rast nuk jam këtu për të folur për një ligj tjetër që nuk ka të bëjë me këtë. ajo që dua të them, edhe si zyrtare, është që janë procedurat ligjore, ligjet, aktet administrative që rregullojnë procedurat dhe përmirësojnë sistemin. Ne jemi këtu për të sjellë një akt, që e gjykojmë se është i përmirësuar dhe, pikërisht, hap aksesin për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që të kenë mundësi të përfitojnë nga ato mundësi që i jep shteti shqiptar, apo financimet e ndryshme. Kështu që, në këtë pikëpamje, me besojmë fort që ky ligj është shumë i mirë.

Komentin tuaj për pjesën e numrit të punonjësve, ne do ta shohim sesi është e shprehur dhe do ta diskutojmë për ta parë sesi është në direktivë e shprehur, pasi mund të ketë lidhje me start-up-et dhe mund të jetë një gjë që e kanë ata, ose mund të jetë një lapsus ose është një lapsus, kështu që do ta shikojmë dhe do ta marrim parasysh.

Në lidhje me pjesën e kriterëve dhe procedurave, ne e theksuam vazhdimisht që vendimet e Këshillit të Ministrave do të jenë të qarta për kriteret dhe procedurat e përfituesve. Patjetër që është AIDA, e cila ka administrimin e këtij fondi dhe të këtyre procedurave. Unë po shikoja listën e përfaqësuesve të këshillit konsultativ. Për shembull, në pikën e fundit janë përfaqësuesit e qeverisjes vendore në këshillin konsultativ. Mendoni pak, në qoftë se ata nuk do të ishin prezentë në një këshill konsultativ, ndoshta nuk do ta merrnin vesh, do të jetë e publikuar në faqe, por nuk kanë rrahjen e mendimeve, të diskutimit, të dialogut, kështu që...

(Diskutime pa mikrofon.)

Dy përfaqësues e ka, sepse e pashë edhe unë, madje në një vend e pashë që ishte te pikat “c” dhe “g” që është e përfaqësuar. E kam fjalën që gjithëpërfshirja sigurohet. Mendoj se janë elemente të nevojshme. Procedurat janë procedura. Më pas jam dakord që t’i shikoj në pjesën e zbatimit se cila funksionon, cila nuk funksionon, por ligjet duhen bërë kështu, duhet parashikuar e gjithë fushëpamja e të gjitha strukturave që janë të nevojshme. Kaq kam për të thënë, sepse ishin komente të përgjithshme, përveç asaj të numrit.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Kam një pyetje, meqenëse bëjmë fjalë që kategorizimi do të ketë lidhje edhe me aplikimet, që do të bëjnë apo me mbështetjen që do të marrin ndërmarrjet. Ju kategorizimin e bëni në bazë të dy kritereve, të numrit të punonjësve dhe të xhiros së afarizmit, nëse në një kriter është mikro dhe në një kriter është ndërmarrje e vogël, cili prevalon?

Arjana Dyrmishi – Në momentin që bëhen kriteret, aty për efekte statistikore merret gjithmonë numri i të punësuarve. Pra, në momentin që do të themi një ndërmarrje e vogël, merret numri i të punësuarve nga 50 deri 250. Mirëpo, në bazë të praktikave europiane, sepse kjo bazë ligjore përdoret edhe nga Bashkimi Europian, në momentin që i jep grante SME-së është në varësi të Këshillit të Ministrave dhe politikave shtetërore që përzgjedhin. Po u referohem eksperiencave që kemi parë. Për shembull, mund të dalë ndihma për të gjitha ndërmarrjet e vogla me qarkullim deri në 150 milionë lekë, ose me 100 mijë euro do të mbështeten vetëm ndërmarrjet mikro me të punësuar deri në 10 punonjës. Gjithmonë, çështja e klasifikimit është e lidhur me prioritetin e dhënies së granteve nga qeveria në momente të caktuara. Vende të ndryshme e kanë përdorur në mënyrë të ndryshme. Për shembull, ne kemi parë që vende të ndryshme kanë dhënë garanci, pra në qoftë se i vutë re, kanë qenë fasha 10 milionë, 50 milionë, në 250 milionë. Ndërkohë, ato thonë do t’u jepen të gjitha SME-ve me qarkullim, pa iu referuar numrit të punësuarve, deri në 150 milionë euro, pra është e varur. Këto konsiderohen kriteret specifikë dhe Këshilli i Ministrave i bën çdo vit, sepse nuk është për gjithë jetën. Këshilli i Ministrave thotë kë do të incentivojë atë vit dhe në atë vit do të incentivojë këtë sektor dhe këto lloje SME-sh dhe më pas shtetet, në bazë të këtyre klasifikimeve, luajnë me prioritetet e tyre se kë do të mbështesin.

(Ndërhyrje pa mikrofon,)

Nëse jeni të interesuar, mund t’jua jap të gjitha vendet se si i kanë dhënë vitin e kaluar.

Arben Pëllumbi – Nëse kolegët nuk kanë pyetje, atëherë kalojmë në shqyrtimin e projektligjit nen për nen.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Fillojmë shqyrtimin nen për nen.

Neni 1 “Dispozita të përgjithshme”. Kreu I ka lidhje me objektin. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Qëllimi”. Në nenin 2 është një fjali parazitare, e cila më duket parazitare, pra mund të qëndrojë, ose mund të hiqet. Neni thotë: “Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të përdorura në politikat shtetërore për t’i mbështetur ato. Kjo fjali më duket...”

Arjana Dyrmishi – Nga e teknikës legjislative e kemi diskutuar formulimin e nenit në detaje edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë. Në fakt, zoti kryetar, e donim këtë, sepse në momente që do të jepen grante, do të referohen, do të bëhet krahasimi në nivel europian, ne do ta përdorim këtë përkufizim të SME-ve. Pra, sikurse përdorin edhe vendet europiane dhe vendet që e kanë adaptuar rekomandimin e 6 majit të vitit 2003 të BE-së për përkufizimet, edhe ne këtë do të japim. Edhe kur japin ndihma shtetërore, edhe kur u japin grante SME-ve, vendet e BE-së këtë klasifikim përdorin në politikat e tyre shtetërore për t’i mbështetur.

Nga ana e teknikës legjislative është e nevojshme një riformulim i tillë.

(Mungesë incizimi)

Ne kemi nevojë të saktësojmë pikat 6 dhe 7. Duke ju kërkuar ndjesë, sepse kanë nevojë bizneset e SME-ve dhe ato që janë SME të reja, që është deri në 12 muaj... Pra, ka nevojë për një saktësim të nenet 6 dhe 7.

(Ndërhyrjet pa mikrofon.)

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme janë të regjistruara në QKB. *(Ndërhyrjet pa mikrofon)*

Arben Pëllumbi – Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe ne, sido që të jetë, edhe ndryshimet që mund të propozojmë, thjesht i kemi në relacionin tonë. Ne nuk i bëjmë dot

ndryshime ligjit. Ndryshimet në ligj do t'i bëjë komisioni përgjegjës, që është Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Arjana Dyrmishi – Na falni, se menduam që ishit ju!

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Atje mund të bëni rregullimet tuaja për këtë projektligj.

Për sa kohë që kolegët tanë nuk kanë ndërhyrje për këtë, ju duhet t'i bëni te komisioni tjetër.

Jemi te neni 5 “Deklarata për kategoritë”.

Kush është dakord me nenin 5? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 “Burimet e të dhënave për llogaritjen e personelit, vlerës së qarkullimit dhe periudhës së raportimit”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7 ka të bëjë me personelin, për periudhën e raportimit.

Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8 “Llogaritja e të dhënave për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu II “Mbështetja shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”.

Neni 9 “Mënyra e dhënies së mbështetjes”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10 “Format e mbështetjes”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në nenin 11 ne kemi një sugjerim në lidhje me titullin e nenit, pra “Mbështetja financiare buxhetore”. Në fakt, këtu flitet për fondin. A mund ta ndryshojmë titullin dhe ta bëjmë “Fondi për zhvillimin”?

Arjana Dyrmishi – Zoti kryetar, ne jemi të hapur, por duam të theksojmë se mbështetja financiare buxhetore është e lidhur me nenin 10, “germa a”. Pra, ne kemi detajuar neni 10, germa “a”, “Mbështetja financiare nga buxheti”. Neni 10 jep elementet: a, b, c dhe ç.

(Diskutime pa mikrofon.)

Arben Pëllumbi – Ne do ta shënojmë në relacionin tonë propozimin që kemi për ndryshimin e titullit dhe do t’ia kalojmë komisionit përgjegjës. Gjithsesi, nuk ndryshon thelbi, është vetëm ideja për të dalë më qartë përcaktimi i nenit.

Kush është dakord me nenin 11, me ndryshimin e titullit, pra me propozimin që t’ia kalojmë komisionit përgjegjës ? Kundër? Abstenim?

(Diskutime pa mikrofon.)

Pra, ju jeni me mendimin që ta lëmë pa këtë propozim.

E hedhim në votim nenin 11 me variantin e propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12 “Garancitë”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13 “Shpërblimet publike për ndërmarrjet”

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14 “Raportet vjetore.”

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15 “Strategjia për zhvillimin e biznesit dhe investimeve”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16 e hedhim në votim, siç është paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu III “Këshilli konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”.

Neni 17 ka të bëjë me këshillin konsultativ.

Urdhëroni!

Lefter Gështenja – Edhe një herë për t’ju kthyer asaj që e diskutova pak më gjatë nga çfarë duhej në lidhje me “Këshillin konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”, po ta shikosh me vëmendje, është diçka që unë vazhdoj të them se është një organ, i cili u mbivendoset organeve të tjera, institucioneve të tjera shtetërore.

Së dyti, është një organ që emërohet me urdhër ministri. Rregullat e hollësishme për kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve, thotë pika 5 e nenit 17, “Për organizmin, funksionimin dhe kompetencat e këshillit konsultativ” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Të nderuara zonja, kush ma thotë nga ju për çfarë duhet ky institucion, që emërohet dhe përcaktohet nga Kryeministri dhe po të njëjtët njerëz në administratën shtetërore, në Agjencinë Kombëtare të Punësimit, në ADISA, apo diku tjetër janë të emëruar nga Kryeministri? Pra, kemi dublim të administratës. Edhe një herë thirrja ime është: hiqni dorë, përtej politikës, të heqim dorë të gjithë bashkë, nga mënyra e drejtimit të institucioneve me borde këshillimuese, apo me organe konsultative. Pra, nuk besoj se ka vend për këtë, sepse kryetari ishte në lëvizje qëparë. E përsëris janë institucione që i paguajnë shqiptarët. Nëse do të merrej mendimi im, më mirë do të preferoja të shtohen njerëz në administratën e ADISA-s apo në organe të tjera, që do t’i menaxhojnë këto fonde, se sa të ngrijmë institucione paralele apo të mbivendosim institucione këshillimore, mbikëqyrëse, vëruani emrin si të doni, që nuk do të kenë ndonjë produkt. Unë për kreun III në total jam kundër.

Kryetari tha se thjesht japim mendim, por besoj se do t’ju shërbejë edhe ju, e nderuar drejtoreshë, se paskeni një eksperience të gjatë në Agjencinë Kombëtare të Punësimit. Eksperienca na ka treguar se këto janë organe që nuk mbajnë përgjegjësi. Cila është përgjegjësia ligjore e tyre, këshillojnë ADISA-n apo një drejtori tjetër në Ministrinë e Financave?

Arben Pëllumbi - Zoti Gështenja, ju lutem, nuk jemi në procesin e diskutimit në parim. E bëmë këtë gjë.

Lefter Gështenja - Nuk isha kryetar. Ta dëgjojmë edhe një herë këtë çështje, ndoshta edhe për ju.

Arben Pëllumbi – Jo. Në rast se keni një propozim konkret, dakord. Këtu flitet vetëm me votë. Pra, një propozim tuajin ne, ose e votojmë kundër, ose e votojmë pro.

Lefter Gështenja - Propozimi im është të hiqet fare kapitulli. Ju shërben edhe juve si maxhorancë, edhe neve si opozitë.

Arben Pëllumbi – Atëherë, përfaqësuesit e ministrisë, kemi një propozim nga kolegu për ta hequr të gjithë kapitullin, duam të dimë edhe mendimin tuaj, në mënyrë që ta votojmë këtë propozim.

Arjana Dyrmishi - I nderuar kryetar, neni 17 flet për krijimin e këshillit konsultativ, i cili nuk ka asnjë lloj përgjegjësie ligjore, përgjegjësinë ligjore e kanë të gjithë ata njerëz që do të firmosin, të cilët do të hartojnë grantet. Cili është roli i këshillit?

Roli i këshillit është që të shërbejë si platformë për të qenë përballë biznesit, për të diskutuar politikatat e tij, sepse VKM-në për grantet do ta bëjmë ne të tria, bashkë me Aidën. Pra, ne jemi nëpunës, në bazë të studimeve, në bazë të eksperiencave që kemi, bëjmë VKM-në, ndërsa biznesi thirret në platformë për të diskutuar, se kemi tregtinë elektronike apo atë gjënë tjetër dhe me radhë, pra për të diskutuar. Të gjithë ndërkombëtarët pyesin: “E keni transparencën me biznesin, i publikoni”? Ky draftligj ka kaluar në një proces të gjerë konsultimi vitin e kaluar dhe çuditërisht nuk pyetën për përkufizimet, anëtarët e biznesit ndërhyjnë edhe te riformulimi, pra përfaqësuesit e biznesit gjatë konsultimit e donin vetë këtë nen, sepse e shikojnë si platformë ku do të flasin dhe do të diskutojnë për politika të ndryshme. Pra, është thjesht platformë, nuk do të merret me grantet, nuk do të japë grante, por në këtë platformë përfaqësues të shtetit do të diskutojnë me bizneset. Madje, në draftin e fillimi kanë qenë pak veta, me sa mbaj mend unë, se konsultimi është bërë para 1 viti, dhe ndërkohë e kemi rritur numrin e përfaqësuesve, pikërisht prej kërkesave të tyre. Pra, e kemi diskutuar me biznesit dhe e donin këtë platformë. Ndërsa këshilli i investime është tjetër gjë.

Arben Pëllumbi – Dakord, e kuptuam, e diskutuam një herë këtë gjë, mos e fillojmë nga e para, se jemi në proces votimi. Ideja është te propozimi që bëri kolegu për ta lënë apo për të hequr të gjithë kreun, që edhe kolegët të jenë të qartë, kështu që ne do të hedhim në votim propozimin e bërë nga kolegu Gështenja.

Kush është dakord që ta heqim kreun 3 nga projektligji, propozim i Këshillit të Ministrave? Kush është kundër? Abstenim? Nuk ka.

Nuk fiton propozim i kolegut Gështenja.

Qëndron kreu 3 në projektligj.

Do të hedh në votim nenin 17 për këshillin konsultativ për ndërmarrjet. Kush është dakord me nenin 17? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në fakt, në nenin 17 unë kam një pyetje. Ju thoni: "... me eksperiencë jo më pak se 5 vjet". A mendoni se një njeri që ka 5 vjet eksperiencë është i aftë të këshillojë, për këtë që thatë ju? Mos janë pak 5 vjet? 5 vjet, një njeri që është nën 30 vjeç sot, mund të bëhet pjesë e këtij këshilli dhe të japë mend dikujt që ka shumë më tepër eksperiencë. Ky është shqetësimi që kam në lidhje me afatin minimal që keni vendori, 5 vjet. Mos janë pak 5 vjet?

Arjana Dyrmishi – Në diskutimet që kemi bërë bashkë me ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë, për të pasur disa kritere, vumë 5 vjet, me idenë që në këtë këshill do të jenë ata njerëz që janë ekspertë, që kanë dy mend për të dhënë. Pra, për të dhënë idenë që nuk do të jenë njerëz...

Arben Pëllumbi – Por nuk na mungojnë rastet kur këshillohemi edhe nga 28- vjeçarë.

Elira Demiraj – E heqim ose e ndryshojmë, jemi të hapur për këtë pjesë. Pra, ideja jonë ishte që të kishim njerëz ekspertë.

Arben Pëllumbi – Propozimi im...

(Ndërhyrje pa mikrofon nga deputeti Lefter Gështenja.)

Zoti Gështenja, ju lutem, me radhë!

Propozimi im për këtë pikë është që të paktën, minimumi të jetë 10 vjet eksperiencë. Pra, të paktën personi të ketë 10 vjet eksperiencë në fusha të ndryshme, që kur mbledhet për të këshilluar, të ketë mundësi të këshillojë. Gjithsesi, ky është një sugjerim, që ne do t'ia kalojmë komisionit në relacion, por e vendosni ju nëse do ta pranoni apo jo, sepse komisioni përgjegjës mund të bëjë ndryshime.

Çështja e dytë që kam lidhet me pikën 3, ku shikoj që thoni: "Anëtarët e këshillit emërohen me urdhër të ministrit". Duhet ta specifikojmë: "...ministri përgjegjës për Ekonominë", pra duhet siç është e specifikuar në krye.

Tjetra, thoni: "... me mandat 3-vjeçar me të drejtë riemërimi". Sa herë mund të riemërohet? Se e thënë kështu, i bie që personi të mund të rrijë atje gjithë jetën. Në përgjithësi, ne kemi një eksperiencë për njerëzit që i zgjedhim si komision, anëtarë bordesh apo të tjerë, që mandatet i kanë 2 ose maksimumi 3-vjeçare. Pra, mendoj se duhet të përcaktojmë një numër mandatesh, sa mund të jetë mandati, pasi dikush mund të jetë këshillues që 30-vjeç dhe del në pension si këshillues. Pra, mund ta themi: "...me të drejtë riemërimi për dy mandate".

Në pikën 4 germa “c” në fund të saj thoni: “... të këtij ligj dhe strategjisë”, pa e përcaktuar se cilës strategji, ndërkohë që flitet për Strategjinë e Zhvillimi të Biznesit dhe të Investimeve, kështu që mendoj se duhet specifikuar lloji i strategjisë, të cilës i referohemi në këtë pikë.

Kështu që, e hedhim edhe një herë në votim nenin 17 me këto ndryshime, për t’ia propozuar komisionit përgjegjës. Kush është dakord? Kundër? Abstenim. Nuk ka.

Miratohet neni 17 me propozimet që do t’i kalojnë komisionit përgjegjës.

Kalojmë te kreu 4.

Neni 18, aktet nënligjore.

Ju thatë se, ndërkohë keni punuar për aktet, por këtu shikoj që keni lënë një vit afat për të përcaktuar aktet nënligjore, dhe ky afat më duket i gjatë, sepse kjo gjë do të thotë që për një vit të mos e vëmë në funksionim këtë ligj, edhe pse e miratojmë duhet të presim një vit. Në qoftë se ju keni filluar punë, ne sugjerojmë që periudha për të përcaktuar aktet nënligjore të jetë 6 muaj. Besoj se edhe komisioni përgjegjës nuk do t’ua kalojë projektligjin me një vit kohë për të përcaktuar aktet nënligjore,

Kush është dakord me neni 18 me sugjerimin që bëme për afatin 6 muaj për aktet nënligjore?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Në qoftë se ju bëheni gati për një muaj, nuk ju pengon askush, por zonja drejtoreshë, e di ku qëndron puna? Se ne aprovojmë ligje, aprovojmë edhe afatet kur duhet të dalin aktet nënligjore, por në mjaft raste aktet nënligjore nuk iu përgjigjen afateve që ne kemi aprovuar këtu. Për këtë arsye Kuvendi i Shqipërisë po mendon që të fillojë edhe një procedurë monitorimi, se si zbatohen vendimet që ne kemi marrë këtu, në kuadër të daljes së akteve nënligjore. Pra, duhet të jemi të bindur dhe të sigurt që brenda 6 muajve ju duhet ta mbaroni këtë gjë. Në qoftë se jeni gati për një muaj, nuk ju pengon askush, të plotësoni aktet nënligjore dhe ta vini në veprimin ligjin, por një vit më duket shumë për të bërë akte nënligjore.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Zoti Beqiraj, ideja është brenda 6 muajve. Në qoftë se këta e bëjnë për një muaj, le ta bëjnë.

Ismet Beqiraj – Ju lutem!

A është me interes ta bëjmë efektive këtë çështje, që të nxisim punësimin, të mbështesim ndërmarrjet dhe të gjitha me radhë? Kur vetë propozuesit, që e kanë mbi shpatulla këtë punë,

thonë se i kanë gati draftimet, që janë gati për një muaj, të mos e lëmë as 6 muaj, as 9 muaj, se po kaluan edhe 6 muaj të tjerë...

Është si rasti kur i lë punët për t'i bërë në fund të dasmës. Problemi është i tillë, që po të ikë i gjithë viti, për vitin 2022 ne nuk i kthejmë në produkte fondet e planifikuara për këtë vit. Pra, minimalisht, kur këta thonë: “Ne jemi gati për një muaj”, të lihet afati 3 muaj, jo deri në 6, por brenda 3 muajve në formë urdhëruese.

Arben Pëllumbi – Unë mendoj se përfaqësuesit e ministrisë, në përgjegjshmëri të punës që kanë bërë deri në këtë moment, na bënë të ditur që janë përgatitur, pra kanë bërë edhe punën përgatitore për projektligjin, por nëse do të vëmë një afat të shkurtër, drejtoreshat sot nuk janë në gjendje të thonë nëse konsultimet edhe me ministrinë e tjera, edhe përgatitja e VKM-ve, mund të jetë brenda këtij afati. Ne e kuptojmë se përgjegjshmëria nuk mungon, sepse puna parapërgatitore është bërë. Pra, ky afat që vëmë ne, nuk do t'i detyrojë dhe do të detyrojë propozuesin që të fillojë punën me intensitet sot, por nëse do të vëmë një afat të shkurtër 1-mujor ose 3-mujor, rrezikojmë që ju të mos e plotësoni këtë afat.

Gjithsesi, nëse doni, zoti Beqiraj, ta bëni një propozim për këtë çështje, unë jam i detyruar ta hedh në votim, në rast se doni që të lëmë propozimin që u bë për 6 muaj, do të e hedhim në votë këtë propozim. Më thoni, është në të drejtën tuaj në se doni të bëni një propozim.

Ismet Beqiraj – Po, propozimi im është që aktet nënligjore, qoftë të Këshillit të Ministrave, qoftë këto të ministrit përgjegjës për Ekonominë, të dalin brenda 3 muaj, të paktën të ngelen 6 muaj, që të përthithet një pjesë e fondeve, nuk i përthithim dot 100%, por të paktën, në kushtet ideale, përthithim 50%, dhe kjo shkon në ndihmë të biznesit.

Kjo është logjika, se e thanë vetë që janë gati.

Arben Pëllumbi – Atëherë, kush është dakord me propozimin e zotit Beqiraj, për ta bërë afatin e nenit 18, në pikën 2, me 3 muaj? 6 vota. Kundër? 4 vota.

Atëherë, fiton propozimi i zotit Beqiraj për 3 muaj, por ju thashë, ky është propozimi ynë, se ju do ta ridiskutoni te komisioni përgjegjës.

Kalojmë te neni 19, i cili ka të bëjë me shfuqizimet. Ju thoni: “Ligji 8957 i datës 17.10.2022, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” i ndryshuar”, shfuqizohet”. E thënë në këtë mënyrë duket sikur në momentin kur ky ligj kalon në Parlament, ligji që është shfuqizohet, por ndërkohë, ju nuk keni filluar ende me ligjin e ri, sepse duhet të botohet në Fletore Zyrtare

dhe duhet të dalin aktet nënligjore, prandaj ne propozojmë të formulohet kështu: “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8957 shfuqizohet...”.

Kush është dakord me nenit 19 me ndryshimin e propozuar për të ndryshuar fjalinë: “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8957, i datës 17.10.2022 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, i ndryshuar”, shfuqizohet”? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20, ka të bëjë me hyrjen në fuqi. Kush është dakord me nenit 20? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kush është dakord me projektligjin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, kolegë!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA